



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 16 dhe 61 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01/20-01-0050862/18, nenet 10,12,34,35 dhe 86 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Programin për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027, nxjerrë këtë:

### **V E N D I M**

#### **Neni 1**

1. Në funksion të parandalimit dhe zvogëlimit të barrës administrative në disa shërbime administrative në Komunën e Podujevës;

- Eliminohen 7 (shtatë) shërbime administrative
- Reduktohen dhe thjeshtëzohen 8 (tetë) shërbime administrative

2. Regjistri i shërbimeve administrative të eliminuara dhe të reduktuara/thjeshtëzuara është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

#### **Neni 2**

Eliminimi dhe reduktimi i shërbimeve administrative sipas nenit 1 bëhet pas analizës së kryer në bashkëpunim me Zyrën për Planifikim Strategjik nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës dhe GIZ-it në lidhje me strukturën dhe procedurat administrative në Komunën tonë, ku rezultoi se një pjesë e shërbimeve të ofruara nuk kanë asnjë bazë ligjore kurse disa shërbime të tjera kërkojnë dokumente të pa nevojshme dhe në numër të madh.

#### **Neni 3**

Zbatimin e vendimit e bëjnë Drejtoritë përkatëse të Komunës.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

#### **U dërgohet:**

Drejtorive Komunale  
Zyrës për Planifikim Strategjik, Zyra e Kryeministrit të Kosovës  
Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal  
QSHQ/ Arkivit

Nr.prot. 02-016/01-0080071/24  
Podujevë, datë 19.12.2024

**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**



**Shërbimet Administrative që eliminohen:**

Nr.	SHËRBIMI	DREJTORIA
1	Vërtetim për mbajtjen e prindit ose prindërve	Drejtoria e Administratës
2	Certifikata e beqarisë	Drejtoria e Administratës
3	Certifikata që personi është në jetë	Drejtoria e Administratës
4	Vërtetim për vizë	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
5	Vërtetim për mbajtje të armës	Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
6	Pëlqim për udhëtim jashtë vendit për fëmijë	Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
7	Pëlqim për dokumente të udhëtimit	Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

**Shërbimet Administrative që reduktohen/thjeshtëzohen:**

Nr.	SHËRBIMI	DREJTORIA	DOKUMENTET QË NUK KËRKOHEM MË NË PROCEDURË
1	Aplikimi në konkurs për praninë në shërbimin publik	Drejtoria e Administratës	1. Kopja e diplomës universitare e noterizuar
2	Korigjimi i emrit personal	Drejtoria e Administratës	1. Certifikata e martesës 2. Certifikata e vendbanimit
3	Akti i vdekjes	Drejtoria e Administratës	1. Ekstraktet e lindjes për personat në jetë
4	Regjistrimi i mëvonshëm i vdekjeve	Drejtoria e Administratës	1. Certifikata e martesës e prindërve të të vdekurit
5	Aplikimi për regjistrim të fëmijës në klasën e parë	Drejtoria e Arsimit	1. Kopja e faturës së energjisë elektrike
6	Aplikimi për regjistrim të fëmijëve në çerdhe përmes konkursit publik	Drejtoria e Arsimit	1. Kontratat e punës të sektorit publik për të dy prindërit
7	Leje pune për autobus, minibus dhe kombibus	Drejtoria e Shërbimeve Publike	1. Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë
8	Vazhdimi i lejes për taxi	Drejtoria e Shërbimeve Publike	1. Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2. Dëshmi që nuk është i punësuar në institucione publike apo private